



Nr. SN/4 prot.

Tiranë, më 5/05 /2015

Për dijeni: REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Lënda: Kriteret e konkursit për programin " Master "

KRITERET E KONKURSIT TË PRANIMIT NË CIKLIN II- MASTER NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA për vitin akademik 2015-2016

Në programet e studimit Master që ofrohen në Fakultetin e Arteve të Bukura pranohen kandidatët që plotësojnë kriteret e mëposhtme :

1. Të kenë kryer programin përkatës të studimit të ciklit të parë " Bachelor " pranë Fakultetit të Arteve të Bukura si dhe ata që kanë kryer programe të tjera të ciklit të parë Bachelor por dhe të ciklit 4 - vjeçar brenda këtij Fakulteti, me ose pa plotësim kreditesh.
2. Pranohen kandidatë që kanë kryer programe studimi nga Fakulteti i Artit Skenik, Programi Studimit Skenografi.
3. Pranohen, gjithashtu, kandidatë që kanë kryer programe studimi jashtë Universitetit të Arteve, me plotësim kreditesh.
4. Në seleksionimin e kandidatëve do të kenë përparësi ata që në ciklin e parë kanë arritur mesataren e notave mbi 7 (shtatë).
5. Faza parë. Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Fakultetit të Arteve të Bukura një dosje që të përmbajë **CV e tij/ të saj dhe dëshmi mbi rezultatet e krijimtarisë gjatë programit të studimit të ciklit të parë : projekte personale, ekspozita etj. (nëse ka) si dhe një studim teorik jo më pak se 5 faqe (Dosja duhet të dorëzohet brenda datës / / 2015, ora 12.00).** Për kandidatët që vijnë nga programe të tjera studimit, jashtë Fakultetit të Arteve të Bukura, në dosje duhet të përfshihen arritje dhe aktivitete në programet përkatëse të studimit, përfshi gjithashtu aktiviteti artistik jashtë shkolle i dëshmuar me postera, fletë palosje, referenca etj.



6. Faza e dytë. Testimi teorik për të gjithë kandidatët të cilët kanë paraqitur Dosjen me përmbatjen e mësipërme dhe brenda afateve të caktuara

7. Kandidatët që kanë kryer programe të tjera studimi, jashtë Fakultetit të Arteve të Bukura, do t'i nënshtrohen një interviste më të zgjeruar me komisionin e ngritur për këtë qëllim pranë këtij fakulteti.

Për çdo sqarim tjetër në lidhje me konkursin, programet e studimit si dhe me plotësimin e krediteve, drejtohuni pranë Fakultetit të Arteve të Bukura.

DEKANI

Prof. Asc. Artan PEQINI

